

Një libër studimor me vlera të mëdha dhe i shkruar bukur

(Rreth librit “Himni Kombëtar” i akademikut Vasil S.Tole)

Këto ditë doli nga shtypi libri “Himni Kombëtar” i akademikut Vasil S.Tole, studimi monografik rreth njërit prej simboleve më të rëndësishme të njësisë dhe bashkimit kombëtar të shqiptarëve. Kam kënaqësinë që këtë libër, ashtu si dhe disa prej botimeve të mëparshme të mikut e kolegut tonë, akademikut Vasil S.Tole, e mora si dhuratë nga autori pikërisht në prag të përrurimit që do t’i bëhet atij libri në Akademi tonë të Shkencave.

Libri është një studim historik dhe muzikologjik, pra edhe disi në shmang të interesave të mia të mirëfillta si gjuhëtar, porse, qysh nga nëntitulli joshës e kureshtjendjellës “Betimi mi flamur” më solli në mendje “betimin mbi gur”, që shqiptarët e zbatonin në raste pajtimesh e përbetimesh. Qysh në kreun e parë të tij, gjeta edhe shumëçka interesante e që dëshmon se udha e himnit tonë kombëtar ka qenë e njëkohshme dhe e njëjtkahshme edhe me dy prej simboleve të mëdha të kombit: me flamurin dhe me njësimin e alafabetit të shqipes dhe, të tria këto simbole kombëtare, do të shenjtëroheshin madhërisht në të njëjtën kohë e në të njëjtin vend: në shpalljen e Pavarësisë dhe në veprën madhore kombëtare të krijimit të shtetit të parë shqiptar të “mosvarëm” nga Ismail Qemal Vlora, më 28 nënto 1912, në Vlorë.

Po lejohem, me këtë rast, të bëj disa vlerësime e shpallime rreth vlerave të këtij libri, të nyjtuara në tri kahe shkencore meritore dhe me vlerë të shënueshme historike dhe aktuale:

Së pari, mund të përmendim vlerat e librit “Himni Kombëtar” në lidhje me tematikën e ngushtë, që lidhet me himnin si krijim poetik dhe muzikor, për të cilin autori, me kompetencë të plotë, shqyrton e përthekon dijet dhe pohimet e bëra më parë dhe ato që i takojnë edhe sot zanafillës dhe realizimit poetik e muzikor të tij. Akademiku V.Tole, ende i ri në moshë, por me përvojë tashmë të gjatë e të respektueshme si muziktar e studiues i shquar i vlerave etnomuzikologjike dhe historiko-kulturore të popullit shqiptar, i ka hyrë kësaj teme duke ndjekur shembullin e muziktarëve pararendës të tij, të prof.dr.Fatmir Hysit, i cili është edhe redaktor muzikor i studimit të pranishëm, po edhe të prof.Ramadan Sokolit e muziktarëve të tjerë. Kështu, në libër janë kundruar, peshuar e vlerësuar pohimet e

nismëtarëve e veprimtarëve adhetarë shqiptarë, të trojeve e të ngulimeve shqiptare jashtë, sidomos të shqiptarëve të Bukureshtit. Autori merr në mbrojtje me të drejtë duke nënvizuar vlerat e mëdha historike e kombëtare të atyre burrave të shquar e atdhetarë shqiptarë, që ia hynë punës për ta realizuar atë, sidomos të poetit e veprimartit atdhetar Aleksandër Stavre Drenovës (Asdrenit), si dhe të krejt vatrës atdhedashëse të shqipatrëve të mërguar me banim në Bukuresht. Aty, me shumë kujdes e me trajtime të argumentuara e të mbështetura në literaturë të gjerë burimore nga botimet e dokumentacioni i arkivave, jepet pamja më e plotë dhe e qartë e udhës së Himnit tonë Kombëtar. Dhe është ajo, në tërësinë e vet, një udhë e ndritur, një udhë që ka shkuar krahas me ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe me përpjekjet e luftën e gjatë të patriotëve dhe ideologëve të Pavarësisë së Shqipërisë për të shkuar në ditën fatlume të shpalljes së pavarësië me “pajën” e nevojshme të solemnitetit të rastit: me Flamurin Kombëtar dhe me Himnin zyrtar të shtetit të parë shqiptar.

Së dyti, duhet theksuar ndihmesa e librit në lidhje me simbolet e tjera kombëtare të shqiptarëve, duke theksuar vlerën përbashkuese të tyre dhe, mbi të gjitha, konsiderojmë të dobishme ndihmesat e këtij studimi për të nxjerrë në pah një rrethanë shumë të rëndësishme e me vlerë kombëtare madhore: lidhjen e ngushtë të përfaqësuese të Shkodrës, Korçës, Vlorës etj. në kahun e mbarë mjedjan”: Geg’e toskë Malësi Jallija, janë një komb m’u da s’duron, fund e maje nja asht Shqypnija, e një gjuhë të tanve na bashkon”.

Libri i Vaso Toles, në një farë mënyre, duke përshkruar udhën që ka përshkuar himini kombëtar i shqiptarëve, ka përthekuar e përmbledhur në mënyrë racionale e të urtë se, në ato vite të ndezura e të ethshme të kurorëzimit, qoftë edhe me aq vonesë, të ëndrrës shumëshekullore për të qënë më vete, shqiptarët e trojeve kompakte ballkanike dhe bijtë e shquar të diasporës në dhe të huaj, u gjendën si kurrë më parë së bashku, pikërist ashtu sikundër e thotë edhe vargu i parë i vjershës së Asdrenit “Rreth falmurit të përbashkuar”. Ata që e pëlqyen, e mbështetën dhe e brohoritën këtë himn, po edhe që e kënduan më zjarr e afsh liridashës, qysh para se të shpallej Pavarësia në Vlorë, kanë qenë figura të mëdha të kombiut tonë, burra të penës e të gishtit të pushkës, si Hilë Mosi nga Shkodra, Pandeli Cale, Thanas V. Floqi, Spiridon Ilo dhe P. Mborja nga Korça, si Murat Toptani, Lef Nosi, Ferit Vokopola etj, të cilët ishin në lidhje e bashkëpunim të ngushtë me figura të tjera të kohës, sidomos nga Korça dhe nga shoqëria e shqiptarëve të Bukureshtit, si

Dhimtitër Zografi, Dhimtitër Mborja e Dhimtitër Berati. Të gjithë ata, në këtë studim përmenden dhe vlerësohen me të drejtë ashtu si u takon dhe lexuesi fiton pamjen më të saktë e të bindshme rreth asaj nisme e përpjekjeje madhore, që do të kurorëzohej me shpalljen e Pavarësisë, më 28 nëntor 1912 në Vlorë.

Së treti, libri nxjerr në dukje dhe pohon sa të rëndësishme kanë qenë për shqiptarët vlerat e himnit, flamurit dhe gjuhës amtare shqipe, si trinomi frymëzues dhe i patjetërsueshëm i shpirtit të kombit tonë. Vetë autori e nis një nga sythat e librit pikërisht me këto fjalë: "Na duhet të pohojmë se flamuri, himni dhe gjuha shqipe, si simbole të identitetit kulturor dhe politik shqiptar, ishin në qendër të ditës së shpalljes së Pavarësisë, si një dëshim e qartë e Shqipërisë "më vehte, të lirë e të mosvarme".(f.87)

Dhe, në këtë pikë, nuk mund të mos ndalem diçka më gjatë, jo thjesht pse jam gjuhëtar dhe më pëlqen mësimi i mbarë që del nga ky libër edhe për vlerat e shqipes e peshën e saj shpirtërore kombëtare të atillë që ka pasur e ka ajo në jetën e konstitucionin shpirtëror të shqiparëve. Kjo, po se po, por, dëshiroj të theksoj edhe disa konotacione aktuale, do të thosha krejt të ditës, që mbart lënda e kësaj vepre lidhur me qëndrimin ndaj shqipes nga Ismail Qemali dhe Qeveria e parë e Shqipërisë së "mosvarme". Kreun e dytë me titullin "Pranimi dhe popullarizimi i himnit kombëtar, përhapja e "këngëve kombiare", autori e nis me sythin e goditur e shumë domethënëse: "Ismail Qemal Bej Vlora, bekuesi i simboleve tona kombëtare", ku shqyrton e mbështet (me dije të shumta dhe referenca të plotvlerëshme) pohimin rreth njohjes që kishte I.Qemali për simbolet shpirtërore për një komb dhe fuqinë e tyre në krijimin e unitetit kombëtar. Dhe, ajo që më intereson më së fortë mua si gjuhëtar,po besoj edhe të gjithë dashamirëve të tjerë të shqipes e të shqiptarisë, është një fakt që e sjell libri i V.Toles në f.88, ku, në mbështetje të vlerësimit për pranimin e gjuhës shqipe si gjuhë të shtetit shqiptar nga qeveria e Ismail Qemalit , sjell edhe një shënim në fund të faqes, ku jepet edhe pohimi dorëmbarë i këtij shtetari e diplomati të urtë. Aty lexojmë: "Në gazetën "Përlindja e Shqipëniës", Viti I, nr.6,17/30 gusht 1913 botohet "Lajmim": "Pas dëshirës dhe n'emën të Zotënies së tij Kryetarit të qeverriës, botojmë këtë lajmim: Duhet të gjithë t'a dijnë mirë se, ç' në ditën fatbardhë që kur Shqipëria dolli më vehte, gjuha shqipe u ba gjuha zyrtare e vendit.Tani, në ç'do degë t'administratës, n'a lipsen nëpunës të cilët t'a njohin mirë, me shkrim e këndim, gjuhën amtare... Edhe nëpunësit që ndodhen në shërbim do të japin provim në gjuhën shqipe: ata që

do të tregohen të zotët, do të konfirmohen në punën që kanë; ata që nuk do të dinë mirë gjuhën shqipe, do të munt të kërkojnë kohë që t'a mësojnë qoftë se kanë dëshirë të mbeten në shërbim.”(Shënimi nr.222)

E citova këtë “lajmim” dhe, pikërisht për vlerat e idenë dorëmbarë që ngërthen ajo nismë e Qeverisë së I.Qemalit, do të lejohem të përmend se, pikërisht atë ide kam pasur parasysh në reagimet e mia të kohëve të fundit të shprehura edhe në artikullin tim ”Shqetësime dhe propozime për kulturën e gjuhës së shtetit”. (Gazeta “Sot”, 20 nëntor, 2013, f.17) Të gjithë jemi dëshmitarë se sot shkollarët dhe pasuniversitarët janë të interesuar dhe, madje, të drithëruar për dhënien provim e pajisjen me dëshminë e njohjes së anglishtes, pra për “Toeflin”, por askush nuk shqetësohet për gjendjen jashtëzakonisht të pamirë të shqipes së shkruar e të folur në zyrat e shtetit, në universitetet publike e private e kudo. Dhe kjo situatë do të vazhdojë nëse nuk do të kemi edhe ne zyrtarisht kërkesën me ligj të provimit dhe njohjes së gjuhës shqipe si kusht për të pasur një vend të caktuar në administratë (vendore apo qendrore). Pra, le ta bëjmë pa humbur kohë atë që pat ideuar dhe shpallur aq bukur e qartë Qeveria e Ismail Qemalit.

Së mbrami, përfundoj duke pohuar se vepra si “Himni kombëtar” i akademikut Vasil S.Tole meritonjë jo vetëm fjalë e vlerësime të mira, por edhe mirënjohje e çmimin më të lartë edhe zyrtar shtetëror. E di se është edhe një institucion, që quhet Akademia-Kult, e cila ndan edhe çmime. Uroj që edhe aty kjo vepër e zotit Tole të pëlqehet e të vlerësohet, por, mbi të gjitha, shfrytëzoj rastin të bëj edhe një propozim tjetër: Akademia jonë e Shkencave duhet të ideojë, ta themelojë dhe ta zbatojë dhënien e çmimeve të larta për veprat më të mira strudimore e shkencore të realizuara me dinjitet e akribi, sikundër është edhe ky libër, vërtet i vlershëm, i kolegut e mikut tonë, akademikut më të ri në moshë, por edhe nga më meritoret që ka Akademia jonë.

Urime të singerta dhe, për ta thënë sipas traditës shqiptare: Të lumshin duart, mjeshtër!

Prof.dr.Gjovalin Shkurtaç

Akademik i asociuar

Anëtar i Këshillit Ndërkademik të Gjuhës Shqipe

